



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Mars 2022

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Mars 2022

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij buletini pasqyrohen
aktivitetet për muajin mars të vitit 2022)**

Lansohet Raporti “Vlerësimi krahasues i të dhënave mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë (2014 – 2020)”

Zëvendëskryesuesi i KPK-së ka marrë pjesë në lansimin e raportit “Vlerësimi krahasues i të dhënave mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë (2014 – 2020)”, i bazuar në metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) për vlerësimin e sistemeve gjyqësore.



Zëvendëskryesuesi shtoi se një raport i tillë ndihmon në përcjelljen e progresit të indikatorëve dhe ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për fuqizim të vazhdueshëm në linjë me standardet më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.

KPK dhe Kolegji UBT nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Kolegji UBT kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi.



Memorandumi i bashkëpunimit parasheh organizimin e aktiviteteve të përbashkëta profesionale, me qëllim të shkëmbimit të praktikave të mira në mes këtyre dy institucioneve.

Nënshkruhet Memorandum i bashkëpunimit mes KPK-së dhe KGJK-së për zbatimin e fazës së katërt të projektit SMIL

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për zbatimin e fazës tranzitore (fazës së katërt) të Sistemit për Menaxhimin Elektronik të Lëndëve (SMIL) në gjykatat dhe prokuroritë e vendit.



Në ceremoninë, u tha se ky akt ndërinstitucional nënshkruhet, duke pasur parasysh kompleksitetin e zbatimit dhe arritjet e deritashme të SMIL-it dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit të mëtejshëm mes KPK-së dhe KGJK-së, në mënyrë që të sigurohet një sistem i qëndrueshëm elektronik, i cili ndihmon në forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë në përputhje me standardet dhe vlerat e BE-së.

Përmbillet procesi i intervistimit të kandidatëve për prokurorë të Shtetit

KPK-ja ka përmbyllur intervistimin e tetë kandidatëve në kuadër të procesit të rekrutimit në nivel të prokurorive themelore.



Me këtë rast janë respektuar të gjitha afatet ligjore të zhvillimit të procedurave rekrutuese dhe janë zbatuar standardet profesionale, gjë që përbëjnë një proces të drejtë dhe transparent të vlerësimit të integritetit personal dhe aftësive profesionale të secilit kandidat.

Nënshkruhet Memorandum i bashkëpunimit mes KPK-së dhe Universitetit "Haxhi Zeka" të Pejë

KKPK-ja dhe Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi.



Ky memorandum i bashkëpunimit parasheh edhe organizimin e simpoziumeve dhe seminareve profesionale të përbashkëta dhe bashkëpunimin në shkëmbim të literaturës shkencore dhe profesionale për studentët e drejtësisë.

Vlerësohet mbështetja e Projektit EUKOJUST për sistemin prokurorial

Kryesuesi i KPK-së ka pritur në takim Drejtoreshën e Projektit EUKOJUST nga IRZ-ja.



Bashkëbiseduesit thanë se ky projekt është duke pasur ndikim të rëndësishme në shumë fusha, të cilat i mbulon në kuadër të sistemit prokurorial, duke shprehur vlerësimin pozitiv për projektin dhe shprehën gatishmërinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm në fusha të interesit të përbashkët.

Deklaratë e Këshillit Prokurorial të Kosovës

KPK, përmes kësaj deklarate, ka shprehur shqetësimin e thellë për miratimin e Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës nga Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj të mbajtur sot më 9 mars 2022, pa u njoftuar Këshilli Prokurorial për draftin final, i cili ishte në diskutim të grupit punues.



KPK-ja ka njoftuar opinionin publik se që nga hartimi i Strategjisë për sundimin e ligjit dhe iniciativat e Ministrisë së Drejtësisë për hartimin e projektligjeve për sistemin prokurorial, edhe pse njëanshëm ishin filluar nga Ministria e Drejtësisë dhe vetëm për sistemin prokurorial, ne, prapëseprapë, së bashku edhe me partnerët ndërkombëtarë kemi dhënë kontribut për të implemnetuar këtë strategji dhe për të hartuar draftin e Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili ka pësuar ndryshime të njëpasnjëshme, duke mos u hartuar parimisht sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias.

Ky nxitim i Ministrisë së Drejtësisë për të proceduar me shpejtësi këtë draft të projektligjit, pa e ndarë draftin final me aktorët e këtij procesi dhe pa i pritur komentet shtesë të Komisionit të Venecias, si dhe pa i marrë parasysh edhe propozimet e dala nga Strategjia për sundimin e ligjit dhe ato të përfaqësuesve të sistemit prokurorial, është tendencë për të cenuar pavarësinë e Këshillit Prokurorial dhe Prokurorit të Shtetit, si institucione të pavarura dhe kushtetuese.

Kjo praktikë tregon qartazi se sponsorizuesi i këtij projektligji, në këtë rast Ministria e Drejtësisë, me vetëdije dhe në emër të reformave synon që të bëjë të kundërtën e reformës - bllokimin dhe defunksionalizimin e sistemit prokurorial.

Çdo iniciativë e këtij lloji, pa respektuar ndarjen e pushteteve, bashkëpunimin dhe koordinimin e ndërsjellë, sjellë dështim dhe krijon hapësirë për ndërhyrje të jashtme në Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Kryesuesi Maloku: Jemi mirënjohës ndaj mbështetjes së vazhdueshme të Zyrës së BE-së për sistemin prokurorial

Kryesuesi i KPK-së priti në takim Këshilltarin për Politika në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë.



Ata diskutuan për aktivitetet e zhvilluara dhe ato që pritet të realizohen në të ardhmen në kuadër të bashkëpunimit të dyanshëm mes sistemit prokurorial dhe Zyrës së BE-së në Kosovë.

Komunikatë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës

KPK-ja ka njoftuar opinionin publik se, Ministria e Drejtësisë ka proceduar në Qeveri Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, pa e marrë opinionin zyrtar të Komisionit të Venecias, i cili në uebfaqen zyrtare të tij ka njoftuar se më 18-19 mars 2022 do të mbajë seancën për trajtimin e kësaj çështjeje.



KPK-ja ka theksuar se, procedimi me shpejtësi i këtij projektligji, pa e ndarë draftin final me aktorët e këtij procesi dhe pa e pritur dokumentin zyrtar nga Komisioni i Venecias, siç ka qenë dakordim në takimin e fundit të Grupit punues të Ministrisë së Drejtësisë, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e sistemit prokurorial, është kundër frymës së bashkëpunimit dhe koordinimit të ndërsjellë dhe

përbën tendencë për të cenuar pavarësinë dhe rregullimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Rikonfirmohen kandidatët për Kryeprokuror të Shtetit

KPK-ja ka rikonfirmuar listën e kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit. Ky rikonfirmim i kandidatëve ka dalë si nevojë pas tërheqjes së një prokurori nga gara për Kryeprokuror të Shtetit.



Po ashtu, KPK-ja ka ftuar më 18 mars 2022 pesë kandidatët për Kryeprokuror të Shtetit për intervistimin e tyre nga Paneli Vlerësues. Kandidatët e rikonfirmuar sot nga Këshilli Prokurorial i Kosovës janë:

Grupi punues për mbikëqyrjen e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike diskuton për Raportin e punës për vitin 2021

Grupi punues për mbikëqyrjen e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike ka mbajtur takim të radhës, me ç'rast diskutoi për Raportin e punës për vitin 2021 dhe rekomandime që dalin nga ky raport.



Gjithashtu, u vlerësua angazhimi i shtuar për realizimin e planifikimeve të punës përgjatë këtij viti.

KPK merr vendim që të publikohen konceptdokumentet e kandidatëve, të monitorohet dhe të transmetohet procesi i emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit

Me qëllim të avancimit të transparencës, llogaridhënies dhe zhvillimit të një procesi kredibil dhe me integritet, të drejtë dhe objektiv, të bazuar në vlerat e barazisë dhe meritokracisë, pas propozimit të Kryeprokurorit të Shtetit, KPK-ja, në takimin e 210-të, mori vendim që procesi i intervistimit të kandidatëve për pozitën e Kryeprokurorit të ri të Shtetit të jetë i hapur për publikun, përkatësisht të monitorohet nga shoqëria civile dhe partnerët ndërkombëtarë, si dhe të transmetohet në Radiotelevizionin Publik të Republikës së Kosovës (RTK).



Po ashtu, KPK-ja mori vendim që Konceptdokumentet e të gjithë kandidatëve të publikohen në uebfaqen zyrtar të sistemit prokurorial.

Mbahet Takimi i 210-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial ka mbajtur Takimin e 210-të, në të cilin miratoi Raportin e punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2021 dhe themeloi Grupin punues për mbikëqyrjen e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024.



U miratua edhe Raporti përmbledhës i Komisionit për vlerësimin vjetor të eprorëve për prokurorët me mandat të përhershëm për vitin 2021 dhe Raporti për vlerësimin e performancës së dymbëdhjetë prokurorëve me mandat fillestar, ndërsa këta të fundit do t'i dërgohen Zyrës së Presidentit për dekretim me mandat të përhershëm.

Sqarim nga Këshilli Prokurorial i Kosovës

Pas shkrimit të publikuar në mediumin "Paparaci.com", me titull "Kokë me më kokë me 'kriminelin'—lidhjet e prokurorit Armend Hamiti me Shaban Kilaq", Këshilli Prokurorial i Kosovës, njoftoi opinionin publik se është duke e analizuar përmbajtjen e shkrimit që atakon prokurorin në fjalë.



Këshilli Prokurorial i Kosovës pret që autoriteti kompetent të ndërmarrë veprime në përputhje me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore për Prokurorë dhe Gjyqtarë dhe nëse ka shkelje eventuale ligjore, KPK-ja do të veprojë në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligj.

Intervistohen pesë kandidatët për Kryeprokuror të Shtetit

KPK-ja organizoi procesin e intervistimit të kandidatëve për Kryeprokurorë të Shtetit, me ç'rast Paneli vlerësues intervistoi pesë kandidatët për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit.



Secili nga kandidatët pati në dispozicion 45-60 minuta kohë për t'u përgjigjur në pyetjet e pesë anëtarëve të

komisionit. Procesi i intervistimit është monitoruar nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, ndërsa të gjitha intervistat janë xhiruar nga Radiotelevizioni i Kosovës dhe nesër e shtunë, 19 mars 2022, të njëjtat do të transmetohen nga ky medium publik.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i KPK-së mbajti takimin e radhës, në të cilin ka diskutuar për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025.



Po ashtu, janë shqyrtuar kërkesat e sistemit prokurorial për pozitat shtesë të personelit, si dhe projektet kapitale.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive diskutoi Raportin për ngarkesën me lëndë të prokurorive dhe numrin e nevojshëm të prokurorëve në prokuroritë themelore, në të cilin paraqiten të dhënat për numrin e prokurorëve në secilin departament të secilës prokurori themelore,



të ngarkuar më lëndë gjatë vitit 2021, numrin e lëndëve në punë, numrin e lëndëve të pranuar,

numrin e lëndëve të zgjidhura dhe numrin e lëndëve të mbetura të pazgjidhura në fund të vitit 2021.

Reagim i Këshillit Prokurorial të Kosovës

KPK reagoi ndaj Raportit të një pjese të organizatave joqeveritare, përkritazi me procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit të ri të Shtetit, me titull “Integriteti i procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit”, i publikuar dje në mediat e vendit.



KPK-ja, vlerësoi se, procesi për zgjedhjen e Kryeprokurorit të ri të Shtetit, që nga fillimi e deri në këtë fazë të intervistimit, ka qenë objektiv, jodiskriminues, transparent, gjithëpërfshirës dhe i bazuar plotësisht në meritokraci.

Publikimi i konceptdokumenteve, intervistimi i kandidatëve në prani të përfaqësuesve të OJQ-ve dhe partnerëve ndërkombëtarë, xhirimi dhe transmetimi i të gjitha intervistave të kandidatëve përmes mediumit publik, Radiotelevizionit të Kosovës (RTK), i cili mundësoi që secili qytetar të përcjellë këtë ngjarje të rëndësishme në sistemin e drejtësisë, padyshim, është dëshmia më e mirë që ky proces, siç e thekson edhe vetë raporti i kësaj pjese të shoqërisë civile, është një praktikë tepër pozitive dhe e pashembullt deri me tani në ndonjë institucion relevant, me ç'rast iu ka dhënë mundësia publikut, OJQ-ve dhe mediave që ta përcjellin drejtpërdrejt dhe në kohë reale këtë ngjarje për zgjedhjen e kandidatit për pozitën më të lartë në sistemin prokurorial.

Prandaj, tendencat dhe gjuha e përdorur nga një pjesë e shoqërisë civile, nuk është asgjë tjetër, përveçse tendencioze, e pabazuar dhe pa asnjë mbështetje ligjore, me prapavijë dhe në shërbim të atyre që kanë intencë të ndërhyjnë në pavarësinë e këtij institucioni të garantuar me Kushtetutë dhe ligjet në fuqi.

Paradoks në vetvete dhe tejet i pakuptueshëm është fakti kur i njëjti raport i këtij koalicioni të një pjese të OJQ-ve i paraqet si fajtorë për një proces të pavarur, të drejtë dhe të paanshëm, një Udhëzues, i cili ka të

bëjë me aplikimin e Nenit 13 dhe 14-të të Rregullores për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës dhe formularët mbi konceptdokumentet e kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit.

Prandaj, kjo është përtej çdo orvatjeje për diskreditim dhe denigrim me çdo kusht të këtij procesi nga ana e disa qarqeve, të cilat nuk ia duan të mirën jo vetëm sistemit prokurorial, por tërë sistemit të drejtësisë, kur dihet se tërë hapat, nga fillimi e deri tek kjo fazë e intervistimit, janë ndërmarrë në plotëni me partnerët tanë ndërkombëtarë, të cilët kanë mbështetur gjithmonë sistemin prokurorial.

Krejt në fund, KPK-ja kërkon edhe nga përfaqësuesit politikë të institucioneve të ndryshme që të respektojnë pavarësinë e pushtetit prokurorial dhe të përmbahen nga çfarëdolloj deklaratash politike, të cilat do të vlerësoheshin si ndërhyrje në këtë proces të zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit.

Kryesuesi i KPK-së priti në takim përfaqësuesit e Fondacionit të Mijëvjeçarit të Kosovës

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës ka pritur në takim Drejtoreshën e Programit të Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) për Kosovë dhe Drejtorin Ekzekutiv të Fondacionit të Mijëvjeçarit të Kosovës.



Me këtë rast, ata diskutuan për financimin e projekteve, që ndërlidhen me fushën e teknologjisë informative nga Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës dhe u prezantuan edhe projektet e sistemit prokurorial.

Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

SKPK-ja, gjatë marsit 2022, ka përgatitur përgjigjet në rekomandimet e misionit vlerësues të korrupsionit dhe krimin të organizuar të vitit 2019 dhe është në proces të përgatitjes inputi i parë i institucioneve vendore në raportin për vendin të Komisionit Evropian.

Gjithashtu janë përgatitur informatat sipas kërkesës së Zyrës së BE-së lidhur me pjesëmarrësit nga sistemi prokurorial në misionin vlerësues për korrupsion dhe krim të organizuar dhe është mbajtur një punëtori rajonale në Budva lidhur me programimin e projekteve të IPA III.

Ndërkohë është organizuar një takim koordinues mes prokurorëve dhe policëve, që do të prezantojnë në misionin vlerësues për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar.

Në zbatim të transparencës publike janë publikuar konceptdokumentet e kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit, të cilat janë vendosur në një vend të dukshëm në uebfaqe e KPK-së.

Grupi punues për definimin e kërkesave për zhvillimin e uebportalit të sistemit prokurorial ka prezantuar draftin e parë të specifikacionit teknik për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit elektronik për menaxhimin e takimeve të KPK (e-këshilli), si dhe është mbajtur takim me përgjegjësitë e Projektit Sfidat e Milleniumit (MCC), ku janë prezantuar kërkesat për avancimin e fushës së teknologjisë informative në sistemin prokurorial.

Gjithashtu është publikuar versioni i ri i Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve, duke integruar pjesën e ankimit dhe bashkimit të lëndëve përfshirë edhe shkëmbimin elektronik në mes të prokurorisë dhe gjykatës për këto dy veprime dhe është publikuar versioni i ri i Sistemit për Elektronik për Menaxhimin e Dosjeve të Prokurorëve i cili përfshin pjesën e raporteve për modulën e trajnimeve dhe disiplinës.

Nga ana tjetër, është përgatitur Raporti i monitorimit të zbatimit të SMIL-it për Prokurorinë Themelore të Mitrovicë dhe është dërguar raporti me të gjeturat e identifikuar të zbatimit të SMIL-it në Prokurorinë Themelore të Gjilanit.

Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Përformancës së Prokurorisë, gjatë muajit mars 2022 kanë pasur në fokusin hartimin e raportit analitik për numrin e nevojshëm të prokurorëve, avancimin dhe transferimin e tyre në departamente dhe prokurori, në bazë të

ngarkesës me lëndë dhe nevojës për rritje të efikasitetit të punës dhe hartimin e raportit përmbledhës të Raportit vjetor të punës së PSH-së për vitin 2021.

Gjithashtu janë përgatitur informata për rastet e iniciuara nga prokurorët me vetiniciativë për periudhën 2019-2021 dhe janë mbledhur të dhënat për hartimin e Raportit për punën e Prokurorit të Shtetit për periudhën 2015–2022, pastaj përgatitjen e listës së objektivave dhe aktiviteteve nga Plani vjetor të Punës së KPK-së për vitin 2022, të cilat e përcaktojnë NJSHP-në si autoritetet përgjegjëse për realizim.

NJSHP-ja ka përgatitur edhe raportin informues lidhur me numrin e lëndëve me kryes të njohur (PP), të cilat kanë qenë punë në prokuroritë themelore dhe PSRK gjatë vitit 2021, raporte dhe informata për strukturën e prokurorëve në sistemin prokurorial, numrin e prokurorëve të angazhuar për periudhën 2015-2022 dhe raporte të tjera sipas kërkesës së organizatave joqeveritare.

NJSHP-ja ka grumbulluar të dhënat nga prokurorët dhe ka përpiluar pasqyra për ngarkesën dhe efikasitetin e tyre në zgjidhjen e lëndëve nga regjistrat: PP, PPM, PPN, PPP dhe NJN për muajin shkurt 2022 dhe ka përgatitur të dhënat statistikore të veçanta për nëntë prokurorë të cilët i nënshtrohen procesit të vlerësimit.

Në kuadër të Programit për Trajnimeve të Vazhdueshme janë realizuar trajnimet online përmes platformës zoom, si vijojnë: “Menaxhimi i stresit”, “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale, mundësinë dhe sfidat”, “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale, mundësinë dhe sfidat”, “Trafikimi i qenieve njerëzore”, pastaj tryeza “Liria e shprehjes dhe liria e mediave”, “Zbatimi i të drejtave pronësore intelektuale”, “E drejta për jetë private, jetë familjare, të vendbanimit dhe korrespondencës, për t’u martuar dhe krijuar familje dhe për barazi të bashkëshortëve – neni 8 Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, “Programi i specializuar i trajnimit për pastrimin e parave dhe hetimin financiar– Sesioni I”, “Program i specializuar i trajnimit për korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare – Sesioni I” dhe Punëtorja “Mbrojtja e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të përfshirë në rastet kundër korrupsionit”.